



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2021

V E N D I M

Nr. _____, Datë ____ / ____ / 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 53 Regj., datë 01.04.2021, të B. Gj-N dhe A. Ll², kundër Bashkisë Mirditë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “lidhjes familjare³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjektet ankues, janë pasardhës të dy prej familjeve të përndjekura dhe persektuara nga ish-regjimi komunist.

Znj. Gj-N, është e bija e të ndjerit N. Gj, djalit të dytë të Gj. M. Gj, mërguar në Amerikë në 1945 për shkaqe politike, i cili ka qenë i përfshirë në listën e të ashtëquajturve reaksionarë të ndaluar të ktheheshin në atdhe, pas mërgimit në Amerikë. Xhaxhai i saj, M. Gj, në 1943 ka qenë ish-

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Referuar si grup personash.

³ Referuar tek lista e shkaqeve të LMD-së, si “çdo shkak tjetër”.

⁴ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD.

Zëvendës Ministër i Brendshëm, N/Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Deputet në Kuvendin Popullor, është pushkatuar pa gjyq nga regjimi komunist më 13 qershor 1946. Xhaxhai tjetër i ankueses, Ll. Gj është pushkatuar pa gjyq më 9 gusht 1947 për motive politike nga regjimi komunist i asaj kohe. Xhaxhai, D. Gj u burgos dhe internua prej regjimit komunist. Ankuesja ka shpjeguar lidhjet e saj familjare me personat sipërcituar, të gjithë të përndjekur nga ish-regjimi komunist i kohës.

Z. A. Ll është nipi i të ndjerit N. P. Lleshi, pushkatuar pa gjyq në 1946 dhe i biri i P. N. Ll, internuar për motive politike gjatë regjimit komunist.

Gjyshërit e subjekteve ankues kanë qenë djem xhaxhallarësh dhe familjet e tyre kanë kaluar nëpër një kalvar të gjatë vuajtjesh e persekutimi nga ish-regjimi komunist.

Subjektet ankues, si trashëgimtarë ligjorë të Gj. M. Gj dhe N. P. Ll, nëpërmjet dokumentacionit poshtëcituar vërtetojnë bashkëpronësinë e pronës së quajtur “Pylla e Qafmollës”:

- Në dokumentin Certifikatë e vitit 1926 përcaktohen kufinj të firmëtarët P. Ll dhe M. Gj si dhe shuma e paguar për pronën e quajtur “Pylla e Qafmollës”.
- Në dokumentin e vitit 1937, Ministria e Ekonomisë Kombëtare, Zyra e Pyjeve vërteton se bazuar në aktin nr. 4317, datë 18.12.1936 “Pylla e Qafmollës” është në ngarkim të subjekteve Gj. M. Gj dhe N. P. Ll.
- Në Fletoren Zyrtare të 16.12.1947, vërtetohet sekuestrimi i pasurisë së tundshme dhe të patundshme për subjektet Gj. M. Gj dhe N. P. Ll.

Lidhur me problematikën e paraqitur pranë KMD-së, subjektet ankues paraqesin se:

Në muajin shkurt 2021, z. A. Ll është paraqitur pranë Bashkisë Mirditë, dhe rastësisht ka parë një shpallje të afishuar nga Bashkia, pa datë, pa afate të përcaktuara, me titull: “Rregjistrimi fillestar i pasurive pyje dhe kullota në pronësi të Bashkisë”.

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, qytetarët njoftoheshin se:

- Po kryhej regjistrimi fillestar i pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Mirditë, sipas VKM nr. 684/2020.
- Nëse dispononin dokumeta pronësie të llojit “pyll” ose “kullotë”, duhet të paraqiteshin me një kopje të dokumentave pranë Zyrës së Bashkisë për të kryer verifikimet e nevojshme.
- Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, ASHK do të lëshojë Certifikatën e Pronësisë në emër të Bashkisë Mirditë.

Subjektet ankues janë shprehur se kanë plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar pranë Zyrës së Bashkisë Mirditë, por punonjësja e këtij Institucioni nuk ka pranuar t’i marrë ato duke argumentuar se: “Zërat kadastral nën titullin “Pylla e Qafmollës” janë plotësuar prej individëve të tjerë”, për të cilët ankuesit pretendojnë se kanë qenë pa akt trashëgimie e dokumentacioni që justifikon lidhjen me pronën.

Subjektet ankues me datë 12.03.2021, i janë drejtuar Bashkisë, duke kërkuar si më poshtë:

- Ti viheshin në dispozicion të gjitha kopjet e formularëve të plotësuar për kalimin e pronës në pronësi të pronës “Pylla e Qafmollës”, formularë të plotësuar dhe dërguar DATECH.
- Informacion se çfarë është dhe si operon DATECH.

- Një kopje të përgjigjeve të ASHK për pronën “Pylla e Qafmollës” lidhur me virtytin e VKM nr. 684/20 që përmbledh njoftimi i afishuar.
- Kopje të gjendjes aktuale juridike të pronës “Pylla e Qafmollës”.
- Informacion nëse Bashkia Mirditë ia ka përcjellë dokumentacionin e tyre të pronësisë Kompanisë DATECH dhe ASHK, depozituar pranë Bashkisë Mirditë që me datë 15.04.2019.
- Bashkia Mirditë të regjistrojë dhe protokollojë kërkesën e tyre si dhe t’u përgjigjej brenda afatit ligjor të parashikuar.

Ankuesit, duke mos marrë asnjë përgjigje, me datë 17.03.2021, i janë drejtuar sërish Bashkisë nëpërmjet një kërkesë tjetër, të cilën e kanë dërguar nëpërmjet shërbimit postar.

Ankuesit kanë pretenduar se Bashkia Mirditë nuk ka regjistruar dhe protokolluar kërkesat e tyre, si dhe nuk i është përgjigjur, duke i diskriminuar pikërisht për faktin se ata i përkasin dy prej familjeve më të sakrifikuara të Mirditës nga ish-regjimi komunist, dhe ky institucion nuk është përkrahës ndaj individëve që burojnë nga këto familje.

Në përfundim, subjektet ankues kanë kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatohet diskriminimi ndaj tyre nga ana e Bashkisë, për sa kanë pretenduar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁵, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

⁵ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 576/1 prot., datë 09.04.2021 Komisioneri ka njoftuar Bashkinë Mirditë lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar informacion e dokumentacion provues prej saj.

Me shkresën nr. 1538/1 prot., datë 22.04.2021, Bashkia Mirditë ka përcjellë pranë KMD, parashitimet e saj lidhur me pretendimet e ankuesit, si dhe ka bashkëlidhur një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

Bashkia ka informuar se: *“Nëpërmjet shkresës me nr. 2558/1 prot., datë 03.07.2019, Bashkia Mirditë i është përgjigjur subjekteve kërkuës, znj. B. Gj dhe z. A. Ll lidhur me planimetrinë dhe statusin juridik të pronave të pretenduara në objektin Qafë-Mollë, Ekonomia Pyjore “Qafë-Mollë”, Njësia Administrative Rrëshen.*

Për sa i përket procedurave që ndjek kompania DATECH për regjistrimin e pasurive të tipit pyje/kullota në pronësi të Bashkisë Mirditë, ju informojmë se kjo Kompani është e kontraktuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për kryerjen e të gjitha procedurave të regjistrimit të pasurive të tipit pyje/kullota pranë Zyrës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), dega Mirditë. Si e tillë, për Bashkinë tonë, kjo Kompani ka filluar procedurat e këtij procesi në vitin 2020, dhe me datë 24.12.2020 ka vendosur shpalljen mbi konsultimin publik të regjistrimit fillestar të pasurive pyje/kullota në pronësi të Bashkisë Mirditë, ku në ambjentet e godinës së vjetër të Bashkisë janë afishuar të gjitha planshetat e zonave kadastrale për të shtatë njësitë administrative të Bashkisë Mirditë.

Në funksion të këtij procesi, Drejtoria Vendore e ASHK Mirditë, me shkresën nr. 2389 prot., datë 24.12.2020, ka shpallur njoftimin publik të afishuar në ambjentet e godinës së Bashkisë dhe ka informuar zyrtarisht: Bashkinë Mirditë, DV ASHK Lezhë dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, ASHK. Një procedurë e tillë është ndjekur për të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Mirditë dhe periudha e konsultimit publik është njoftuar 45 ditë nga dita e shpalljes.

Lidhur me pretendimet mbi pronësinë e pyjeve të Qafë-Mollës, Bashkia Mirditë, me shkresën me nr. 629 prot., datë 10.02.2021 (data e fundit e priudhës së takimeve konsultative) nga ana e jonë i është dërguar Kompanisë DATECH dokumentacioni i paraqitur nga shtetasi P. B. Gj, që sipas tij i përket pasurive pyje të trashëguara prej të parëve të tij.

Të nesërmen e kësaj date, me të njëjtin dokumentacion është paraqitur shtetasi A. Ll, të cilit i është bërë e ditur se, për të njëjtat prona dhe me të njëjtin dokumentacion, ka aplikuar dy ditë më

parë shtetasi P. B. Gj, dhe në këto rrethana u gjykua se nuk ishte e nevojshme të përsëritet e njëjta praktikë në emër të personave të tjerë. Gjithsesi, këtij shtetasi i është bërë me dije se, për probleme të kësaj natyre gjithsecilit i njihet e drejta të kontaktojë me kompaninë përgjegjëse për regjistrimin e pasurive, si dhe DV ASHK Mirditë”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë de të pafavorshëm.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjektet ankues janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me shtetas/individë të tjerë në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”.

A.1 Lidhur me pretendimin e subjekteve ankues, se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshme nga ana e Bashkisë Mirditë, përsa i takon mosregjistrimit të kërkesës së tyre.

Bazuar në analizimin e fakteve e kronologjinë e ngjarjeve, rezulton se:

Kompania DATECH, është kompani e kontraktuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për kryerjen e regjistrimit të pasurive të tipit pyje/kullota në pronësi të Bashkisë Mirditë, tek zyra e DV ASHK Mirditë. Lidhur me këtë funksion të saj, Kompania ka filluar procedurat e këtij procesi në vitin 2020, dhe me datë 24.12.2020 ka vendosur shpalljen mbi konsultimin publik të regjistrimit fillestar të pasurive pyje/kullota në pronësi të Bashkisë dhe në ambjentet e katit të dytë, të godinës së vjetër të Bashkisë ka afishuar të gjitha planshetat e zonave kadastrale për çdo njësi. Pyjet/kullotat e Qaf-Mollës, prona për të cilën ankuesit shprehen se janë trashëgimtarët ligjorë të saj, është e përfshirë në zonën kadastrale nr. 2769.

Nëpërmjet shkresës me nr. 2389 prot., datë 24.12.2020, DV ASHK Mirditë ka shpallur njoftimin publik duke informuar njëherësh: Bashkinë Mirditë, DV ASHK Lezhë, ASHK dhe Ministrinë e Mjedist dhe Turizmit. Një procedurë e tillë është ndjekur në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Mirditë dhe periudha e konsultimit publik është njoftuar 45 ditë nga dita e shpalljes, nga data 28.12.2020, deri me datë 10.02.2021.

Subjektet ankues, pasi kanë ardhur në dijeni të njoftimit të bërë nga Bashkia Mirditë lidhur me procedurat që duheshin ndjekur për regjistrimin fillestar të pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë, kanë plotësuar gjithë dokumentacionin e kërkuar.

Nga aktet e depozituara pranë KMD-së, rezulton se, me datë 08.02.2021, shtetasi P. B. GJ ka depozituar fletë-kërkesat, duke kërkuar specifikisht:

- Heqjen nga fondi pyjor i Bashkisë i ngastrave që përfshihen në tapinë e viti 1926, nga ngastra 1-25, ekonomi pyjore Qaf-Mollë, ngastrat 103-106 ekonomi pyjore G.P Velës dhe

kalimin e pasurisë në pronësi të tij. Këto parcela me nr. pasurie nga 276-304 të ekonomisë pyjore Qaf-Mollë janë të përfshira në pyjet në pronësi të Bashkisë.

- Heqjen nga fondi pyjor i Bashkisë i ngastrave që përfshihen në tapinë e viti 1926, nga ngastra 130-137, ekonomi pyjore G.P Velës dhe kalimin e pasurisë në pronësi të tij. Këto parcela me nr. pasurie nga 103-106 të ekonomisë pyjore G.P Velës janë të përfshira në pyjet në pronësi të Bashkisë.
- Heqjen nga fondi pyjor i Bashkisë i ngastrave që përfshihen në tapinë e viti 1926, të ngastrave 21 a, 21 b, 22 a, 22 b, 23 a, 24, 25, të ekonomisë pyjore Qaf-Mollë dhe kalimin e pasurisë në pronësi të tij. Këto parcela janë në fondin e Bashkisë me nr. pasurie 117 të ekonomisë pyjore Qaf-Mollë.

Nëpërmjet shkresës me nr. 629 prot., datë 10.02.2021 Bashkia Mirditë i ka përcjellë kompanisë DATECH kërkesat sipërcituar dhe dokumentacionin e shtetasit P. B. GJ.

Të nesërmen e aplikimit të shtetasit P. B. GJ, janë paraqitur ankuesit për të bërë aplikimin lidhur me kërkesat për heqjen nga fondi pyjor i Bashkisë për pasuritë e tyre ekonomi pyjore.

Rezulton e pranuar nga palët në proces, se, punonjësja e këtij Institucioni nuk ka pranuar të marrë kërkesën dhe dokumentacionin e tyre, duke argumentuar se, të njëjtët zëra kadastral, nën titullin “Pylla e Qafmollës” janë plotësuar prej shtetasit P. B. GJ.

Subjektet ankues kanë pretenduar se P. B. Gj, personi që ka aplikuar, ka qenë pa akt trashëgimie e dokumentacioni dhe nuk justifikonte lidhjen me pronën e pretenduar, dhe kërkesat e dokumentacioni i tyre duhej pranuar nga ana e Bashkisë.

Me datë 12.03.2021 ankuesit i janë drejtuar shkresërisht Bashkisë, duke i kërkuar të regjistrojë dhe protokollojë kërkesën e tyre si dhe t’u përgjigjej brenda afatit ligjor të parashikuar⁶. Kjo kërkesë i është dërguar e përsëritur Bashkisë dhe me datë 17.03.2021.

Nëpërmjet e-mailit të datës 26.03.2021 Bashkia i është përgjigjur ankuesve, duke i informuar ndër të tjera⁷ se, në dokumentacionin e depozituar nga shtetasi P. B. GJ përsa i përket pasurive pyje të trashëguara nga të parët e tij dhe përcjellë prej tyre kompanisë DATECH, ndër pretendentët e aktit të trashëgimisë janë edhe ata.

Nga qëndrimi i mbajtur nga palët në këtë proces administrativ, si dhe referuar dokumentacionit të sjellë prej tyre, rezulton e provuar se:

- Me datë 08.02.2021, shtetasi P. B. GJ ka depozituar kërkesat pranë zyrës së Bashkisë Mirditë të cilat i janë pranuar dhe regjistruar nga ana e saj.
- Me datë 10.02.2021 subjektet ankues janë paraqitur pranë zyrës së Bashkisë, për të depozituar kërkesat dhe dokumentacionin respektiv, bazuar në shpalljen e bërë prej saj, por u janë refuzuar nga ana e punonjësit të këtij Institucioni, me argumentimin se të njëjtat

⁶ Shih fq. 2 dhe 3 të Vendimit.

⁷ Pika 4, e e-mailit.

kërkesa dhe të njëjtin dokumentacion kishte paraqitur dhe një person tjetër, i cili kishte aplikuar përpara tyre.

Bazuar në sa më sipër cituar, Komisioneri vlerëson se, nga ana e Bashkisë Mirditë janë keqzbatuar dhe shkelur dispozitat ligjore ku parashikohet detyrimi i saj si Insitucion për t'i shërbyer pa dallim dhe në mënyrë të barabartë të gjithë shtetasve.

Referuar ngjarjes/rastit konkret, bazuar në nenin 23, pika 1 dhe 2 e Kushtetutës, Komisioneri thekson se, e drejta e informimit është një e drejtë kushtetuese e si e tillë është e garantuar dhe se kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetore.

Në nenin 13, të KPA, *“Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë”*, është sanksionuar se, organi publik, në ushtrimin e funksioneve të tij, trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Përsa i takon detyrimin të organeve publike/institucioneve shtetërorë për të zbatuar parimin e barazisë, neni 17 i KPA, ka përcaktuar se, organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë dhe palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë.

Neni 59/1, i KPA, ka përcaktuar se: *“Kërkesa paraqitet drejtpërdrejt në organin publik kompetent ose në çdo zyrë apo degë të tij. Kërkesa drejtuar një organi publik qendror mund të paraqitet edhe në çdo prefekturë, në territorin e së cilës pala ka vendqëndrimin, nëse organi publik qendror nuk ka zyrë ose degë në atë territor”*.

Neni 60, pikat 1/3, i KPA, *“Regjistrimi dhe vërtetimi i paraqitjes së kërkesës”*, ka përcaktuar shprehimisht se:

“Marrja e kërkesës regjistrohet në organin publik ku paraqitet, sipas rendit kronologjik të paraqitjes në një regjistër të posaçëm. Regjistri i kërkesave për fillimin e procedurës administrative përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin e kërkesës;*
- b) datën e dorëzimit;*
- c) objektin e kërkesës;*
- ç) numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës;*
- d) identitetin dhe adresën e kërkuarit.*

Personit që paraqet kërkesën, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim që konfirmon faktin e pranimit të kërkesës, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, nëse ka të tilla. Depozitimi me postë të porositur vërtetohet nga dokumenti postar që duhet të përmbajë të njëjtat të dhëna”.

Komisioneri sjell në vëmendje se, informacioni i kërkuar nga subjekti ankues apo çdo subjekt tjetër i ndodhur në kushte të njëjta, është një informacion i cili i duhet dhënë personit, bazuar në parashikimet ligjore të nenit 6, të Kodit të Procedurës Administrative (KPA), të ndryshuar,

“Parimi i informimit”, i cili përcakton se: “Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit”.

E drejta e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, është objekt i rregullimit ligjor të parashkuar në ligjin nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, të ndryshuar.

Pika 3 e nenit 3, të këtij ligji, sanksionon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”.*

Po ashtu, pika 2, e nenit 2, të tij, përcakton se: *“Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”.*

Ligji nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, në nenin 19⁸/1/2 të tij, përcakton se: *“Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t’u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore.*

Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t’i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj”.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, Bashkia Mirditë ka trajtuar në mënyrë të padrejtë subjektet ankues.

Me të njëjtin objekt, shtetasit P. B. Gj i ka pranuar, regjistruar dhe përcjellë pranë DV ASHK Mirditë, kërkesat dhe dokumentacionin respektiv, ndërsa subjekteve ankues u ka refuzuar një shërbim të tillë, ndërkohë që detyrimi i tyre ishte thjesht përcjellja e kërkesave dhe dokumentacionit të depozituar nga shtetasit, bazuar në shpalljen bërë. Shqyrtimi, analizimi dhe vlerësimi i tyre i takon organeve të tjera të cilave u përcillen këto akte.

Në këtë kontekst, Bashkia, haptazi ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme subjektet ankues, krahasuar me shtetasin P. B. GJ, ndodhur në të njëjtat kushte.

Veprimet e Bashkisë janë të pabazuara dhe në shkelje të parashikimeve ligjore lidhur me të drejtën e shtetasve për të paraqitur kërkesa para cilitdo organ shtetëror dhe detyrimin e këtyre institucioneve për t’i trajtuar ata në mënyrë të drejtë e të barabartë, pa i diferencuar në shërbimin e ofruar.

B. Shkaku i mbrojtur.

B.1 Shkaku i pretenduar i subjekteve ankues, vlerësuar si “çdo shkak tjetër”.

⁸ Neni 19 “E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes”.

Mbështetur në nenin 2⁹, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për cilindo nga shkaqet që parashikon ky ligj.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹⁰. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹¹.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

- Referuar citimit sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se “lidhjet familjare” të ankuesve shërbejnë dhe përbëjnë një element lidhës, në kontekst të provimit të faktit se ata janë

⁹“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

¹⁰ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

¹¹ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

pasardhës dhe trashëgimtarë të familjeve të M. Gj dhe P. Ll, gjë e cila, në përputhje me rrethanat e çështjes *mund* të kishte shërbyer si shkak për trajtimin e padrejtë apo të pafavorshëm të tyre nga ana e Bashkisë Mirditë.

- Ankuesit kanë pretenduar se janë diskriminuar pikërisht për faktin se ata i përkasin dy prej familjeve më të sakrifikuara të Mirditës nga ish-regjimi komunist, dhe ky institucion nuk është përkrahës ndaj individëve që burojnë nga këto familje.
- Në kontekst të faktimit të prejardhjes së tyre, si pjesë e pandarë dhe trashëgimtarë të dy prej familjeve të persekutuar të Mirditës nga ish-regjimi komunist i kohës.

Diskriminimi¹² karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesit arritën ta identifikonin dhe provonin se e posedonin atë.

Subjektet ankues kanë provuar lidhjet familjare me Gj. M. Gj dhe N. P. Ll:

Znj. Gj-N, është e bija e të ndjerit N. Gj, djalit të dytë të Gj. M. Gj, mërguar në Amerikë në 1945 për shkaqe politike, i cili ka qenë i përfshirë në listën e të ashtëquajturve reaksionarë të ndaluar të ktheheshin në atdhe, pas mërgimit në Amerikë. Xhaxhai i saj, M. Gj, në 1943 ka qenë ish-Zëvendës Ministër i Brendshëm, N/Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Deputet në Kuvendin Popullor, është pushkatuar pa gjyq nga regjimi komunist më 13 qershor 1946. Xhaxhai tjetër i ankuses, Ll. Gj është pushkatuar pa gjyq më 9 gusht 1947 për motive politike nga regjimi komunist i asaj kohe. Xhaxhai, D. Gj u burgos dhe internua prej regjimit komunist. Ankuesja ka shpjeguar lidhjet e saj familjare me personat sipërcituar, të gjithë të përndjekur nga ish-regjimi komunist i kohës.

Z. A. Ll është nipi i të ndjerit N. P. Ll, pushkatuar pa gjyq në 1946 dhe i biri i P. N. Ll, internuar për motive politike gjatë regjimit komunist.

Gjyshërit e subjekteve ankues kanë qenë djem xhaxhallarësh dhe familjet e tyre kanë kaluar nëpër një kalvar të gjatë vuajtjesh e persekutimi nga ish-regjimi komunist.

Subjektet ankues, si trashëgimtarë ligjorë të Gj. M. Gj dhe N. P. Ll, nëpërmjet dokumentacionit poshtëcituar vërtetojnë bashkëpronësinë e pronës së quajtur “Pylla e Qafmollës”:

- Në dokumentin Certifikatë e vitit 1926 përcaktohen kufinj të firmëtarët P. Ll dhe M. Gj si dhe shuma e paguar për pronën e quajtur “Pylla e Qafmollës”.
- Në dokumentin e vitit 1937, Ministria e Ekonomisë Kombëtare, Zyra e Pyjeve vërteton se bazuar në aktin nr. 4317, datë 18.12.1936 “Pylla e Qafmollës” është në ngarkim të subjekteve Gj. M. Gj dhe N. P. Ll.

¹² “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

- Në Fletoren Zyrtare të 16.12.1947, vërtetohet sekuestrimi i pasurisë së tundshme dhe të patundshme për subjektet Gj. M. Gj dhe N. P. Ll.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson, “*të qënurit e subjekteve ankues, të persekutuar*” (si pjesëtarë dhe trashëgimtarë të dy familjeve të persekutuar të Mirditës, nga ish-regjimi komunist i kohës, gjë e cila rezultoi e faktuar nëpërmjet lidhjeve familjare që subjektet ankues kanë me M. Gj dhe P. Ll), si shkak të mbrojtur të LMD-së, referuar si “*çdo shkak tjetër*”¹³.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin, se subjektet ankues janë ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Mirditë, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe trajtimit të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm të tyre.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*”. Neni 18, i saj shpreh se: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*”.

Ky parim përshkon edhe nenin 48 të Kushtetutës sipas të cilit “*Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj*”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të*

¹³ Neni 1 i LMD-së: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Sipas nenit 5/1 të LMD-së, “ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

- a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;*
- b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se subjektet ankues janë diskriminuar, duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesit janë trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar subjektet ankues në të drejtën për të aksesuar shërbimet publike, në mënyrë të barabartë dhe të padiferencuar.
- në krahasim me, sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët, në një situatë të ngjashme, në rastin konkret krahasuar me P. B. Gj;
- dhe arsyeja për këtë trajtim është e lidhur me një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji, të qenurit të persekutuar.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të*

provvojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjektet, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jenë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁴

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtuar nga ankuesit, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ata i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tyre për të marrë shërbimin nga ana e Bashkisë në mënyrë të barabartë me shtetasit e tjerë, dhe në rastin konkret me shtetasin P. B. Gj. *Së dyti*, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i subjekteve ankues, nga ana e Bashkisë, lidhet me shkakun e mbrojtur dhe ka ardhur pikërisht prej tij.

C.1 Lidhja midis trajtimit të padrejtë dhe më pak të favorshëm të subjekteve ankues me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹⁵, Komisioneri vlerëson se subjektet ankues i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë, krahasuar me shtetasin P. B. Gj.

¹⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁵ Shih Ndarjen III, nëndarja A, të vendimit të KMD.

Ankuesit kanë pretenduar se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë për shkak të “*të qënurit të persekutuar*” (provuar nga lidhjet familjare, si trashëgimtarë të shtetasve P. Ll dhe Gj. M. Gj, për të cilët fakti i ekzekutimit me vdekje nga ish-regjimi komunist, është fakt i njohur botërisht).

Mirëpo, pavarësisht konstatimit të këtij fakti, ankuesit nuk arritën të provojnë dhe dokumentojnë se shkak i pretenduar prej tyre ka shërbyer si shkak për të cilin ata janë diskriminuar nga ana e Bashkisë.

Ky pretendim i ankuesve është i pabazuar pasi, gjatë hetimit, u provua që edhe shtetasi P. B. Gj, të cilit Bashkia i ka ofruar shërbimin lidhur me pranimin e kërkesës të datës 08.02.2021, mbart të njëjtin shkak si ankuesit.

Në emailin e datës 26.04.2021, dërguar nga subjekti ankues¹⁶ në adresë të KMD-së, ndër të tjera, citohet se: “*P. B. Gj është kushëri por jo trashëgues me akt trashëgimie dhe prokurë për subjektet Gj. M. Gj dhe N. P. Ll e gjithsesi as i autorizuar nga ana jonë për të kryer veprime në emër të subjekteve trashëgimlënës Gj. M. Gj dhe N. P. Ll¹⁷. Baballarët tanë janë kushërinj dhe është e vërtetueshme se edhe prindi i tij ka qenë i persekutuar, gjë kjo që nuk justifikon për Bashkinë për mosregjistrimin e kërkesës tonë për informacion dhe për të mos iu pergjigjur kërkesave tona.*

Ne e ndiejmë veten të diskriminuar nga Institucioni i Bashkisë për faktin e mosregjistrimit, protokollimit dhe dhënies përgjigje për informacion publik, i cili mund të na kishte orientuar më lehtë për ta zgjidhur çështjen tonë.

Ju njoftojme se i P. B. Gj nuk është trashëgimtar i përbashkët i pasurisë pasi nuk është trashëgues legjitim me akt trashëgimie dhe nuk ka lidhje direkte trashëgimie as me subjektin Gj. M. Gj dhe as me subjektin N. P. Ll”.

Referuar përmbajtjes sa më sipër, Komisioneri, nuk ka analizuar faktin nëse P. B. Gj është apo jo trashëgues legjitim me akt trashëgimie, apo nëse gëzon të drejta trashëgimie mbi pronat e pretenduara nga subjektet ankues, pasi këto janë kompetencë e shqyrtimit të organeve të tjera administrative apo gjyqësore.

Komisioneri vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ankuesit janë ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Komisioneri ka marrë në konsideratë vetëm faktin se shtetasi P. B. Gj gëzon të njëjtin shkak si subjektet ankues, në kontekst të qënies së tij, si pjesë e një familjeje të persekutuar të Mirditës nga ana e ish-regjimit komunist të kohës.

Bazuar në lidhjet familjare të tij, në faktin që ai është kushëri i subjekteve ankues dhe bazuar në deklaratimet e vetë ankuesve, që edhe P. B. Gj është pasardhës i një familjeje e cila po ashtu ka qenë e persekutuar nga ish-regjimi komunist i kohës, rezulton e provuar se, si subjektet ankues, ashtu edhe P. B. Gj gëzojnë të njëjtin shkak, pra janë pjesëtarë dhe pasardhës të familjeve të persekutuar nga ish-regjimi komunist, vërtetuar pikërisht nga prejardhja e tyre familjare.

¹⁶ Komunikimi me e-mail është realizuar me njërin prej subjekteve ankues, B. N. Gj.

¹⁷ Referuar nga ankuesit vepra "Vargu i Letrave shqipe", akti 175

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, qënia e ankuesve si pjesë e dy prej familjeve më të persekutuar të Mirditës, nga ish-regjimi komunist i kohës, nuk mund të ketë shërbyer si shkak për trajtimin e tyre të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Bashkisë.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pavarësisht konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm ndaj ankuesve nga ana e Bashkisë, lidhur me mosmarrjen dhe protokollimin e shkresave të tyre me datë 10.02.2021, dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit, *“të qënurit të persekutuar”*, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar prezumimin se kjo sjellje të cilës i janë nënshtruar subjektet ankuesit, është si rezultat i posedimit të këtij shkakut, dhe se në mungesë të tij, ankuesit do të ishin trajtuar ndryshe.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, Bashkia Mirditë nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesit nuk përbën diskriminim.

Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t’u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Përsa kohë rezulton e provuar se, të njëjtin shkak si ankuesit posedon edhe personi P. B Gj., i cili është përdorur si *“krahases”*, Komisioneri vlerëson se sjellja e Bashkisë ndaj ankuesve mbetet në kuadër paligjshmërie, por nuk provohet që ajo të jetë motivuar nga shkakut i pretenduar prej tyre.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur nga subjektet ankues me pretendimin për diskriminim, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për shkak të *“të qënurit të persekutuar”*, është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që Bashkia të ketë shkelur dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjekteve ankues, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Mirditë, për shkakun e pretenduar prej tyre.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: “Çdo shkak tjetër”
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim